



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Deçanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Deçanit (KD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Deçanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësi dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Shpalosja e pasurive jo financiare në PFV nuk ishte e plotë dhe e saktë, ngase ishin nënvlerësuar për 965,276€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Deçanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B2 Mos verifikimi i 20% të gjendjes aktuale të objekteve.
- B3 Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari.
- B4 Emërimi dhe angazhimi i zyrtarëve për kryerjen e shërbimeve të veçanta jo në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat e zbatueshme.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Deçanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Deçanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Deçanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Deçanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Deçanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë procesit të auditimit, kemi identifikuar disa fusha ku mund të përmirësohet performanca duke përfshirë kontrollin e brendshëm. Testet tona kanë treguar që nevojiten përmirësime në menaxhimin e pasurive, të hyrat, llogaritë e arkëtueshme, pagesa e faturave brenda afateve ligjore, menaxhimi i personelit, verifikimi i objekteve për tatim në pronë, dhe auditimi i brendshëm.

Në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV), u vërejtën mangësi në raportimin financiar. Qëllimi i gjetjeve dhe rekomandimeve tona është që të korrigjohet informacioni financiar i paraqitur në pasqyrat financiare, përfshirë edhe shënimet shpjeguese ku synohet përmirësimi i kontrolleve të brendshme për raportimin financiar dhe sigurimi që komuna e Deçanit të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret për menaxhimin e fondeve publike. Vlen të theksohet se Komuna e Deçanit kishte progres në regjistrimin e tokave në vlerë 40,000,000€ në regjistrin e pasurive mbi 1,000€ gjatë vitit 2024 si dhe pasuritë e blera për vitet 2020-2023 në vlerë 9,000,000€.

Gjithashtu theksojmë se shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore për kontratën kolektive të arsimit për vitin 2024, ishte 877.054€. Prej tyre, borxhi kryesor ishte 522.742€, ndërsa 354.312€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimi. Ndërsa pagesat e mundeshme të realizuara për punëtorët shëndetësor për borxhin kryesor ishte 8,697€ për vitin 2024.

Raporti i auditimit ka rezultuar me gjithsej shtatë (7) rekomandime prej tyre një (1) rekomandim të ri dhe gjashtë (6) rekomandime të përsëritura. Ne do ti përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mangësi në regjistrat e pasurive kapitale dhe jo kapitale

- Gjetja** Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 6.1 përcakton që: “çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj, tutje neni 6.3 përcakton që: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria”.
- Gjatë auditimit është vërejtur se pasuritë jo financiare kapitale nuk janë regjistruar plotësisht në regjistrat përkatës në SIMFK. Në këtë sistem mungon regjistrimi i të gjitha blerjeve kapitale të vitit 2024 në vlerë 965,276€, që përfshijnë investime në infrastrukturen, rrugore / urat, infrastrukture në rrjetin e kanalizimit, investime në objekte, etj. Përveç kësaj, zhvlerësimi vjetor nuk është aplikuar për një pjesë të pasurive, përfshirë rastin e projektit për renovimin e zyrave në objekte komunale, ku vlera origjinale e investimit ishte 52,765€, por zhvlerësimi i akumuluar rezultonte zero, ndonëse pasuria ishte pranuar që në fund të vitit 2014.
- Kjo ka ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të kontrollit të brendshëm për ti regjistruar pasuritë jo financiare në regjistrat përkatës dhe aplikuar zhvlerësimin.
- Ndikimi** Mungesa e regjistrimit të plotë dhe të saktë të pasurive jo financiare kufizon aftësinë e menaxhmentit për të pasur një pasqyrë të qartë mbi pasuritë që zotëron komuna, çka çon në nënvlerësim të vlerës së tyre dhe pasqyrim të pasaktë në pasqyrat financiare vjetore, duke cenuar kështu transparencën dhe llogaridhënien.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë funksionimin efektiv të kontrollit të brendshëm dhe të forcojë koordinimin ndërmjet zyrtarit të pasurisë dhe departamentit të financave, në mënyrë që të gjitha pasuritë komunale të identifikohen, regjistrohen dhe zhvlerësohen në kohë, duke garantuar saktësi dhe përputhshmëri me kërkesat ligjore në raportimet financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B2 - Mos verifikimi i 20% të gjendjes aktuale të objekteve

Gjetja

Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, neni 15, pika 2 përcakton se; Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Nga 7,234 objekte të evidentuara në bazën e të dhënave, komuna ka regjistruar 221 prona të reja, si dhe kishte arritur të kryej 60 modifikime, gjithsej janë kryer 284 verifikime nga të gjitha pronat apo rreth 4%.

Megjithëse në krahasim me vitin e kaluar ka ulje për rreth 7%, niveli i përqindjes së verifikimit është i ulët, prandaj kërkohen ende veprime konkrete për përmirësimin e gjendjes në të terren.

Mos verifikimi i pronave mungesës së anketuesve në terren dhe kontrolleve të pa mjaftueshëm në sektorin e tatimit në pronë.

Ndikimi

Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllime të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të objekteve të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari

Gjetja

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi (LMFPP) nr. 03/L-048 neni 39.1 përcakton se; çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbime e funrizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ndërsa sipas nenit 40 fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrin të prerë nga gjykata/përmbartuesi. Po ashtu ligji për marrëdhëniet detyrimeve nr. 04/L 077 neni 382.2 taksativisht parasheh; Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Gjatë testimit të pagesave të ekzekutuara nga komuna kemi vërejtur se në pesë (5) raste në vlerë 108,791€ të pagesave të cilat kanë kaluar afatin ligjor prej 30 ditësh për ekzekutim. Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur se ka pasur kërkesa për inkasimin e mjeteve nga OE përmes procedurave përmbartimore/gjyqësore. Megjithatë, nga analiza e raportit të shpenzimeve kemi vërejtur se përmes procedurave përmbartimore/gjyqësore dhe në bazë të vendimeve gjyqësore, ishin paguar 4,388,918€, për kategorinë e paga dhe shtesa 1,313,966€, mallra dhe shërbime 981,958€, komunal 14,799€,

subvencione dhe transfere 10,668 € dhe investime kapitale pagesa ne shume 2,067,528€, shpaloseni informa sa jene bere pagesa per borgjin kryesore dhe sa jane bere pagesa per shpenzimet percjellese. Kjo formë e pagesave, përveç keqklasifikimit, ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve të procedurave përmbartimore dhe interesit. Vetëm në një rast, vendim/urdhër përmbartimor P.nr. 239/2024, për vonesën e pagesave të obligimeve, është aplikuar interesi në kamatë vonesë në vlerën 2,379€.

Hyrja në obligime është si shkak i kontraktiveve dhe realizimeve të punëve pa pasur buxhet të mjaftueshëm dhe mos përgjegjësisë së zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mosrealizimin e pagesave brenda afatit kohorë ligjor që ka rezultuar më pagesën e tyre përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore më shpenzime shtesë për procedurat përmbartimore dhe kamatëvonesat.

Ndikimi Si pasojë e vonesave në pagesa dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar likuiditetin e saj nga vendimet përmbartimore përmes thesarit ka ndikim direkt në rritjen e kostos për komunën.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbartimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Emërimi dhe angazhimi i zyrtarëve për kryerjen e shërbimeve të veçanta jo në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat e zbatueshme

Gjetja Ligji i punës nr. 03/L-212, neni 10, paragrafi 6 përcakton se, Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë (120) ditë brenda një (1) viti, Ligji për Zyrtarët Publik nr.06/L-114, neni 84 përcakton se, Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshjet në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik.

Komuna kishte angazhuar 33 punonjës përmes Marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MShV), prej tyre 26 në administratën komunale, në zyrën e kryetarit dhe drejtorin të ndryshme, shtatë (7) në shëndetësi. Për këta punonjës komuna nuk ka zhvilluar as procedurë formale të rekrutimit as procedura të prokurimit për MShV, por janë angazhuar me vendime të kryetarit të komunës. Për 33 punonjës kishte vendime për kohë të caktuar deri në gjashtë (6) muaj, ndërsa 6 të tjerë nga shtatë (7) deri në dymbëdhjetë (12) muaj dhe 5 tjerë kishin vendim deri në përfundim të mandatit të kryetarit. Prej tyre 10 punonjës vazhdojnë të jenë të angazhuar edhe në vitin 2025. Angazhimi i tyre nuk është bërë për shërbime të veçanta apo detyra specifike, por për pozita të rregullta të punës.

Angazhimi i stafit pa procedura ka ndodhur për shkak se kanë mungesë të punëtorëve dhe pamundësisë së zhvillimit të procedurave të rekrutimit si dhe nevojave për mbulimin e pozitave pas pensionimit të disa punonjësve. Ndonëse duhet theksuar se kjo çështje trajtohet në vazhdimësi në raportet e auditimit.

Ndikimi Emërimi i zyrtarëve për pozita të rregullta për periudhë të caktuar dhe angazhimi me kontrata për një detyre specifike me afat më të gjatë kohë dhe pa procedura është në kundërshtim me legjislacionin përkatës. Njëherit kjo rrit rrezikun e angazhimit të stafit jo kompetent për pozita të caktuara duke eliminuar konkurrencën dhe mundësitë e barabarta për punësim.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të prokurimit për angazhimin e stafit për MShV. Si dhe, të sigurojë se kjo formë e angazhimit aplikohet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat janë të arsyeshme nga njësitë kërkuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2024 ishin në vlerë 871,000€. Ato kanë të bëjnë me kryesisht me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Çështja B5 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë

Gjetja	<p>Neni 12 i Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, përcakton se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë ashtu siç përcaktohet në aktin nënligjor.</p> <p>Neni 3 i Ligjit Nr.08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, përcakton se për vendbanimin parësor deri në tridhjetë mijë (30,000) euro e para të pronës së vlerësuar të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit.</p> <p>Neni 7 i Udhëzimit Administrativ Nr.03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin , paragrafi 1.1 specifikon “ Të dhënat për tatimpaguesin përfshijnë numrin personal identifikues (tatimpaguesit fizik)”.</p> <p>Pas analizës së bërë, në lidhje me zbatimin e zbritjes së lejuar për vendbanimin parësor dhe zbatimit të Vendimit për regjistrimin e numrit personal, janë identifikuar se për 711 tatimpagues, është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, duke u mbështetur në nenin 11 - “Zbritjet për vendbanim parësor”, mirëpo kjo zbritje është bërë për pronat e personave për të cilët nuk ishte evidentuar numri personal.</p> <p>Kjo çështje ishte bartur nga vitet paraprake dhe për shkak të stafit të pa mjaftueshëm në sektorin e tatimit në pronë nuk është arritur që të azhurnohen të dhënat në Protax.</p>
Ndikimi	Zbatimi i zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit pa numër personal dhe pa u deklaruar se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me përlogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë dhe rrjedhimisht më pak të hyra.
Rekomandimi B5	Kryetari duhet të shtoj kontrollat që të sigurojë se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për tatimpaguesit. Pastaj të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit/azhurnimit të shënimeve në bazën e të dhënave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Të arkëtueshmet

Komuna e Deqanit në PFV e vitit 2024 ka shpалosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 3,030,789€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 3,014,641€ dhe qiraja nga prona publike 16,148€.

Çështja A1 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjoben nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në perputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo me vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna në PVF e vitit 2024 ka shpалosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 3,030,789€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 3,014,641€ dhe qiraja nga prona publike 16,148€, vetëm tatimi në pronë është rritur për 238,160€ në krahasim me vitin 2023.

Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme është mospërbushja e detyrimeve ligjore nga ana e komunës për ndjekjen dhe mbledhjen e borxheve tatimore.

Ndikimi

Mungesa e mekanizmave dhe efikasitetit për inkasim të borxheve nga debitort mund të shkaktoj probleme në përmbarueshmërinë e planit të shpenzimeve, ndërsa vjetërsia e tyre zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që borxhi të inkasohen.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përbushin obligimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Përveç planit strategjik, NJAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës për vitin 2024, i cili parashihte zhvillimin e gjashtë auditimeve. Të gjitha këto auditime janë realizuar dhe kanë mbuluar fushat kryesore si: të hyrat dhe të arkëtueshmet, menaxhimi i personelit, shpenzimet nga të gjitha kategoritë ekonomike, procedurat e prokurimit dhe menaxhimi i kontratave. Periudha e auditimit kishte në fokus kryesisht vitin 2024. Gjatë vitit, Komiteti i Auditimit ka mbajtur katër takime, ku është diskutuar rreth punës dhe raporteve të NJAB-së.

Çështja B6 - Mungesa e stafit dhe planeve të veprimit në adresimin e rekomandimeve të NjAB-s

Gjetja Rregullorja 01/2019 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, neni 5.1.1 përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë. Po ashtu, sipas Rregullores 01/2019 për Themelimin dhe zbatimin e auditimit të brendshëm neni 9, pika 7 - Auditorët e brendshëm monitorojnë zbatimin e rekomandimeve në mënyrë sistematike sipas planit të veprimit të miratuar nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik. Gjithashtu sipas nenit 10 pika 1.3 të së njëjtës rregulloreje - Është përgjegjësi e udhëheqësit të subjektit të sektorit publik për auditimin e brendshëm për të siguruar zbatimin e rekomandimeve për të cilat janë pajtuar për auditimin e brendshëm sipas planit të veprimit.

Në Komunën e Deçanit, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) përbëhet vetëm nga drejtori dhe një anëtar, ndonëse kërkohet të ketë së paku tre auditorë.

Njësitë e audituara nuk kishin hartuar plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB në raportet e auditimit të brendshëm. Si rezultat, shumica e rekomandimeve nuk janë adresuar në mënyrë të duhur nga menaxhmenti.

Kjo situatë ka ardhur si pasojë e mungesës së buxhetit të ndarë për plotësimin e numrit minimal të auditorëve, në përputhje me kërkesat ligjore. Po ashtu, mosadresimi i rekomandimeve lidhet me neglizhencën dhe mungesën e përgjegjësisë nga ana e zyrtarëve të drejtorive përkatëse.

Ndikimi Numri i pamjaftueshëm i auditorëve dhe mungesa e planeve për zbatimin e rekomandimeve zvogëlon efektivitetin e funksionit të auditimit të brendshëm, duke bërë që të mos trajtohen në kohë dhe mënyrë adekuate çështjet e identifikuar. Si rezultat, menaxhmenti nuk përfiton në mënyrë të plotë nga vlerësimet dhe rekomandimet e NjAB-së për përmirësimin e proceseve dhe kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të ndërmarrë masa për të siguruar buxhetin e nevojshëm për plotësimin e strukturës së NjAB-së me numrin minimal të auditorëve, në përputhje me kërkesat ligjore. Po ashtu, duhet të kërkojë nga njësitë e audituara hartimin dhe zbatimin e planeve konkrete të veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm, duke forcuar kështu llogaridhënien dhe kontrollin e brendshëm në nivel të drejtorive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	13,508,082	14,799,784	14,616,641	13,362,912	10,801,693
Grante Qeveritare - Buxheti	12,660,517	13,773,614	13,744,933	12,369,409	9,713,779
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	94,003
Të bartura nga viti i kaluar	0	157,136	155,998	182,351	322,938
Të hyrat vetanake	847,565	847,565	712,910	775,302	669,476
Donacionet vendore	0	17,002	0	0	1,496
Donacionet e jashtme	0	4,468	2,800	35,850	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,291,702€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar për 157,136€, donacioneve vendore për 17,002€ dhe të jashtme për 4,468€.

Në vitin 2024, janë shpenzuar 99.% e buxhetit final ose 14,616,641€, me një rritje 9.38% krahasuar me vitin 2023.

Vlene te theksohet se ne kete performance buxhetore prej 99 kan ndikuare edhe pagesate me vendime gjyqsore ne vlere prej 4,388,918 € apo 30% e totalit te pagesave te realizuara ne vitin 2024

Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	13,508,082	14,799,784	14,616,641	13,362,912	10,801,693
Pagat dhe mëditjet	7,294,440	8,407,537	8,407,537	7,166,907	5,934,913
Mallrat dhe shërbimet	2,548,828	2,667,895	2,637,579	1,997,058	1,844,173
Komunalitë	250,000	250,000	249,690	199,991	195,491
Subvencionet dhe transferet	290,000	290,103	289,031	207,422	152,100
Investimet Kapitale	3,124,814	3,184,250	3,032,804	3,791,534	2,675,016

Shpjegimet për ndryshimet në kategorinë e buxhetit janë dhënë si më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin fillestar, është rritur për 1,113,097€. Shpenzimet në këtë kategori janë realizuar në 100% të buxhetit dhe përbëjnë 57.5% të shpenzimeve totale. Shpenzimet janë rritur me 17% krahasuar me vitin 2023.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, krahasuar me buxhetin fillestar, është rritur për 119,067€. Shpenzimet për këtë kategori janë realizuar në 98.86% të buxhetit dhe përbëjnë 18.% të shpenzimeve totale. Shpenzimet janë rritur me 32.% krahasuar me vitin e kaluar.
- Buxheti final për shërbimet komunale ka mbetur i njëjtë me atë fillestar, 250,000€. Shpenzimet në këtë kategori janë realizuar afër 100% të buxhetit dhe përbëjnë 2% të shpenzimeve totale. Shpenzimet janë rritur me 25% krahasuar me vitin 2023.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere, krahasuar me buxhetin fillestar, është rritur për 103€. Shpenzimet në këtë kategori janë realizuar afër 100% të buxhetit dhe përbëjnë 2% të shpenzimeve totale. Shpenzimet janë rritur me 39.% krahasuar me vitin 2023.
- Buxheti final për investime kapitale është rritur për 59,436€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet janë realizuar 95. të buxhetit dhe përbëjnë 21% të shpenzimeve totale. Shpenzimet janë zvogëluar me 20.% krahasuar me vitin paraprak.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2024 ishin në vlerë 871,166€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë në vlerë 520,054€, dhe të hyrat jo tatimore në vlerë 351,112€, të cilat përfshijnë: lejet e ndërtimit, taksat për legalizimin e objekteve, taksat për çertifikata dhe të tjera administrative, etj.

Po ashtu, Komuna për vitin 2024 kë pranuar të hyra nga gjambat nga trafiku në vlerë 148,431€ të cilat alokohen për shpenzim në baza të rregullta tremujore. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mësipërme, pasi ato planifikohen dhe realizohen nga Ministria e Punëve të Brendshme po ashtu, nuk janë përfshirë as të hyrat nga gjambat e shqiptuara nga gjykatat, në vlerë prej 12,500€.

Në vitin 2024, të hyrat krahasuar me vitin 2023 janë rritur për 8% apo 66,420€ më shumë.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	847,565	847,565	871,166	804,746	689,783
Të hyrat tatimore	589,265	589,265	520,054	505,170	387,433
Të hyrat jo tatimore	258,300	258,300	351,112	299,577	302,350

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV-të) për vitin 2023 të Komuna e Deqanit (KD) ka identifikuar dymbëdhjetë (12) rekomandime për të përmirësuar efikasitetin dhe proceset. KD ka zhvilluar një plan veprimi për të adresuar këto rekomandime në mënyrë të detajuar. Gjatë periudhës së auditimit për vitin 2024, gjashtë (6) nga rekomandimet janë zbatuar me sukses, ndërsa pesë (5) ende nuk është adresuar dhe një (1) rekomandim ishte zbatuar pjesërisht. Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë duke vendosur komunikimin ndërmjet zyrtarit të pasurisë në njërin anë dhe departamentit të financave në anën tjetër për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale dhe PFV.	Janë regjistruar pronat komunale/tokat të vlerësuara mbi 40,000,000€.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për opinion	Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet që kanë ndikuar në mbivlerësimin e detyrimeve kontingjente për të siguruar se shpalosjet e tyre janë të plota dhe të sakta në PFV.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përbarimit.	Nuk janë ndërmarrë veprimet, raste të ngjashme ka edhe gjatë vitit 2024.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të prokurimit për angazhimin e stafit për MShV. Si dhe, të sigurojë se kjo formë e angazhimit aplikohet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat janë të arsyeshme nga njësitë kërkuese.	Nuk janë ndërmarrë veprimet, raste të ngjashme ka edhe gjatë vitit 2024.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e kontratave publike të lidhura (nënshkruara) për projektet kapitale të janë në përputhje me shumat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë së pari që të gjitha mallrat dhe shërbimet kontrahohen paraprakisht dhe bëhet pranimi i autorizuar sipas kushteve kontraktuale, para veprimeve tjera në shpenzimin e parasë publike.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
8.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se lidhja e kontratave të punës (ndërtimit) të bëhet bazuar në projektin ekzekutiv mandator me qëllim të përcaktimit të saktë të lokacioneve dhe objektivave që do të arrihen në realizimin e projektit.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
9.	Të hyrat	Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të sigurojë se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për tatimpaguesit. Pastaj të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit/azhurnimit të shënimeve në bazën e të dhënave.	Nuk janë ndërmarrë veprimet për përmirësime.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të objekteve të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.	Nuk janë ndërmarrë veprimet për përmirësime.	Nuk ka filluar zbatimin

11.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.	I zbatuar.	I zbatuar
12.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB. Po ashtu, duhet të sigurojë përgatitjen e planeve të veprimit nga njësitë e audituara për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe njëherësh të sigurojë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB.	Nuk janë ndërmarrë veprimet për përmirësime.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Deçanit, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Komuna e Deçanit pajtohet me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e përgjithshme të Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Bashkim Ramosaj

Kryetar i Komunës së Deçanit

Data: 03 Qershor 2025

Nënshkrimi: Se



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.